



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT DHE
PROJEKTEVE

Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

RELACION TEKNIK

Objekti : Rehabilitim I shkarjes ne rrugen Qerim Banaj, Dukas

Investitor : Bashkia Patos

Qellimi

Rehabilitimi I shkarjes ne rrugen Qerim Banaj ne lagjen Dukas dhe sigurimi I shpateve ne pjesen e sipërme te rruges. Kthimi I kesaj rruge ne parametra optimale dhe te sigurte per levizjen e banoreve te kesaj zone.

Rruga eshte demtuar nga shirat e dimrit te sivjetshem (dhjetor 2020-Janar 2021). Ne disa pjese te saj kemi reshqitje te shpateve te rruges nga ana e veriore (skarpata ne ane te peroit) dhe per rrjedhoje kemi ngushtimin e saj duke rezikuar izolimin e banoreve nga mjetet motorike ne rast te ndonje urgjence te mundeshme.

Kjo rruge perdoret nga pake shtepi te cilat ndodhen ne fund te saj.

Bazuar edhe ne kerkesen e vazhdueshme te banoreve qe banojne ne kete pjese lagjeje eshte hartuar ky project per kthimin e kesaj rruge ne gjendjen e meparshme.

Krijimi dhe mirembajtja e kesaj rruge do te sherbeje ne nje jetese me te sigurte per banoret aty prane qe perdorin cdo dite kete rruge per tu lidhur me qytetin e Patosit.

Objektivat e realizimit të këtij projekti janë:

- Rehabilitimi I pjeses se demtuar te kesaj rruge dhe kthimi I saj ne gjendjen optimale per sherbimet e ndryshme per banoret e zones;



- Sigurimi I shpateve ne pjesen e sipërme te rruges per mbrojtjen e saj nga reshkitjet e mundshme dhe bllokimin e rruges per banoret e zones
 - Ndertimi I kanaleve kulluese te rruges dhe drejtimi I ketyre ujrave ne tombinon ekzistuese
- Qellimi kryesor I investimit eshte zgjerimi dhe permiresimi I kesaj pjese rruge te demtuar nga shirat e dimrit te sivjetshem dhe kthimi I saj ne gjendjen e meparshme per ti sherbyer banoreve te zones

Pershkrimi I punimeve qe do te kryhen

Duke patur parasysh qellimin e ketij investimi, dhe mbeshtetur ne detyren e projektimit, grupi I projektimit hartoi projektin e zbatimit, elementet kryesore te te cilit jane si me poshte:

Punime Germimi

Punimet e germimit konsistojne ne heqjen e shtrese ekzistuese te reres bituminoze ne nje gjaatesi rreth 114 ml dhe germimi ne shpatin e pjeses se sipërme te rruges ne anen jugore. Germimiet perfshine punime me krahe dhe me mjet ne kete segment. Do te germohet per bazamentin e murit mbjates se skarpates ne pjese e sipërme te rruges por edhe per kanalet ne pjesen anesore te saj. Punimet e germimit perfshijne pastrimin e tombinos dhe ndertimin e pusetes shimbledhese te saj. Largimi I dherave te tepert dhe depozitimi I tyre eshte parashikaur ne preventiv

Punime betony e b/a

Ne punimet e betonit dhe b/a perfshihet ndetimi I pusetes ne tombino per mbledhjen e ujrave te shiut dhe grumbullimin e tyre ne tombino si edhe ndertimi I murit b/a mbajtes per sigurimin e shpatit ne anen e sipërme te rruges. Punime betony jane parashikuar betonimi I kanalit te grumbullimit te ujrave te sipërfaqesore nga shpatet e kodres dhe nga rruga. Ky kanal do te shtrihet ne te gjithë gjatesine e parashikuar te nderhyrjes ne kete pjese rruge.

Punime shtresash

Ne punimet e shtresave perfshihet shtresa baze me cakell guroreje per pjesen e rruges qe do te zgjerohet dhe nje shtrese stabilizanti me trashesi $t=10$ cm ne te gjithë gjatesine e nderhyrjes. Shtresa e sipërme e rruges do te jete me material rere bituminoze me trashesi $t=10$ cm. kujdes I vecante do ti kushtohet rulimit te shtresave te rruges per te siguruar nje jetegjatesi me te mire.

Per cdo ndryshim apo pamundesi ndertimi sipas te dhenave te projektit duhet te njoftohet grupi projektimit.

Punoi: **ing. Arben Manoku**

Miratoi: **Dr. Urb Ledio Capo**